

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. nr. 276/2011
Prishtinë
28 shkurt 2012

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës mbajti seancën e kolegjit në pajtueshmëri me Nenin 26 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe Nenin 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhja e Lëndëve dhe Caktimi i Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK) më 24 nëntor 2009 në ndërtesën e Gjykatës Supreme të Kosovës në kolegin e përbërë prej gjyqtarit ndërkombëtar Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve vendorë Emine Mustafa, Valdete Daka, Avdi Dinaj dhe Marije Ademi si anëtarë të kolegjit,

Dhe me Holger Engelmann si procesmbajtës,

Në praninë e

Avokatit mbrojtës B [REDACTED] M [REDACTED] për të pandehurin H [REDACTED] I [REDACTED]

Avokatit mbrojtës J [REDACTED] M [REDACTED] për të pandehurin B [REDACTED] I [REDACTED]

Në lëndën penale me numër AP-KZ 276/2011 kundër të pandehurit:

H [REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]
dhe
[REDACTED]
[REDACTED]

B [REDACTED] I [REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]

Në pajtueshmëri me aktgjykimin e shkallës së parë së Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë në lëndën P. nr. 84/08, të datës 31 mars 2011 dhe të regjistruar në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të njëjtën ditë, të pandehurit janë shpallur fajtorë për këto vepra penale:

H [REDACTED]
[REDACTED]

[i] Për shkak se më 21 maj 2008 rrëth orës 15:30, duke vepruar si grup, në parkingun e marketit EMONA në Vushtrri, ka dërguar (shpërndarë) pa autorizim substancë të rrezikshme narkotike marijuanë me qëllim të shitjes së saj, ashtu që pas takimit që

patën i pandehuri B [REDACTED] I [REDACTED] së bashku me B [REDACTED] K [REDACTED] me blerësin e quajtur G [REDACTED] në lagjen e Dardanisë, domethënë tek kafet e Santesë, ata u pajtuan të kryejnë shitjet tek marketi EMONA. Kur ata mbërritën tek marketi EMONA, B [REDACTED] K [REDACTED] dhe B [REDACTED] I [REDACTED] u takuan me G [REDACTED] përsëri dhe G [REDACTED] i dha 1800 EURO të dëshmitarët, ashtu që ai do t'i sillte atij dy kilogram marijuanë. B [REDACTED] I [REDACTED] e kontaktoi me telefon H [REDACTED] I [REDACTED] dhe jo më larg se pas pesë minutash, pasi që e kanë marr një taksi veturë, H [REDACTED] I [REDACTED] dhe S [REDACTED] S [REDACTED] arritën tek restaurant EMONA. Pastaj, S [REDACTED] shfrytëzoi të njëjtën taksi veturë të shkoj në ndërtesën e Kuvendit Komunal të Mitrovicës, zbriti nga vatura dhe pranoi një çantë të zezë nga njëz të panjohur, e cila përbante dy kilogram të substancës narkotike (marijuanë) që peshonin 22.2 gram. Duke shfrytëzuar të njëtin taksi veturë, dëshmitarët që peshonin 22.2 gram. Duke shfrytëzuar të njëtin taksi veturë, S [REDACTED] u kthye në restaurant EMONA në Vushtrri, dhe ia dorëzoi çantën që përbante narkotikët të pandehurit H [REDACTED] I [REDACTED] i cili ia pasoi blerësit G [REDACTED] prej të cilit ai i pranoi 1800 EURO. Policia intervenoi menjëherë gjatë shkëmbimit dhe i kapi të pandehurit. Policia konfiskoi dy kilogram dhe 6 qese të marijuanës nga i pandehuri H [REDACTED] I [REDACTED] [...].

Duke vepruar kështu, i akuzuari H [REDACTED] I [REDACTED] ka kryer dhe është penalistë përgjegjës për veprën penale Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike në kundërshtim me nenin 229, paragrafin 2 i lidhur me paragrafin 4, pikën i të KPK-së;

[ii] Sepse më 21 maj 2008 rrëth orës 15:30 i akuzuari H [REDACTED] I [REDACTED] kishte armën pistoletën COLT 7.65 mm, me numër serik 42340, e prodhuar në Gjermani, që kishte 5 plumbë me vete në parkingun e marketit EMONA në Vushtrri.

Duke vepruar kështu, i akuzuari H [REDACTED] I [REDACTED] ka kryer dhe është penalistë përgjegjës për veprën penale Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim me nenin 328, paragrafin 2 të KPK-së.

Prandaj, ai është dënuar si në vijim:

I akuzuari është dënuar për veprën penale Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike në kundërshtim me nenin 229, paragrafin 2 i lidhur me paragrafin 4, pikën i të KPK-së me burgim prej tri (3) vite dbe për veprën penale Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim me nenin 328, paragrafin 2 të KPK-së me burgim prej një (1) viti. Gjykata e shkallës së parë i dha një dënim unik prej tri (3) vite dbe gjashtë (6) muaj në pajtueshmëri me nenin 71, paragrafin 1 dhe 2, pikën (2) të KPPK-së.

Koha e kaluar në paraburgim ose në arrest shtëpiak prej datës 21 maj 2008 deri më 3 korrik 2009 është vendosur të llogaritet në pajtim me nenin 73, paragrafin 1 të KPK-së.

B [REDACTED] I [REDACTED]

Për shkak se më 21 maj 2008 rrëth orës 15:30, duke vepruar si grup, në parkingun e marketit EMONA në Vushtrri, ka dërguar (shpërndarë) pa autorizim substancë të rrezikshme narkotike, marijuanë me qëllim të shitjes ashtu që pas takimit që patën, me

të pandehurin B [REDACTED] I [REDACTED] së bashku me B [REDACTED] K [REDACTED] me blerësin e quajtur G [REDACTED] në lagjen Dardania, dormethënë tek kafet e Santesë, ata u pajtuar që të kryejnë shitjet tek marketi EMONA. Kur ata mbërritën tek marketi EMONA, B [REDACTED] K [REDACTED] dhe B [REDACTED] I [REDACTED] u takuan me G [REDACTED] përsëri dhe G [REDACTED] i dha 1800 EURO të pandehurit, ashtu që ai do t'i sillte atij dy kilogram marijuanë. Pastaj B [REDACTED] I [REDACTED] e kontaktoi me telefon H [REDACTED] K [REDACTED] dhe jo më larg se pesë minuta, pasi që e morri taksi veturn, H [REDACTED] K [REDACTED] dhe S [REDACTED] S [REDACTED] arritën tek restaurant EMONA. Pastaj S [REDACTED] shfrytëzoi të njëjtën veturë taksi që të shkoj në ndërtesën e Kuvendit Komunal në Mitrovicë, zbriti nga vetura dhe pranoi një çantë të zezë nga njerëz të panjohur, e cila përbante dy kilogram të substancës narkotike (marijuanë) dhe gjashtë qeseve që peshonin 22.2 gram. Duke shfrytëzuar të njëjtën veturë taksi, S [REDACTED] u kthye në restaurant EMONA në Vushtrri, dhe e ia dorëzoi çantën që përbante narkotikët të pandehurit H [REDACTED] K [REDACTED] i cili ia pasoi blerësit G [REDACTED], nga i cili ai pranoi 1800 EURO. Policia intervenoi menjëherë gjatë shkëmbimit dhe i kapi të pandehurit. Policia konfiskoi dy kilogram dhe 6 qese të vogla të marijuanës nga i pandehuri H [REDACTED] I [REDACTED] dhe tri qese të vogla marijuanë nga i pandehuri B [REDACTED] I [REDACTED].

Duke vepruar kështu, i akuzuar B [REDACTED] I [REDACTED] ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitia e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike në kundërshtim me nenin 229, paragrin 2 i lidhur me paragrin 4, pikën i të KPK-së;

Prandaj, ai është dënuar me një (1) vit burgim për veprën penale Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitia e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike, në pajtueshmëri me nenin 67, paragrin 1, pikën ii të KPK-së, përderisa koha e kaluar në paraburgim ose arrest shtëpiak prej datës 21 maj 2008 deri më 23 shtator 2009 është vendosur të llogaritet në pajtueshmëri me nenin 73, paragrin 1 të KPK-së.

Përderisa i pandehuri B [REDACTED] I [REDACTED], i cili është dekluar fajtor para trupit gjyques, nuk është ankuar në aktgjykimin e shkallës së parë, avokati mbrojtës i të akuzuarit H [REDACTED] K [REDACTED] me kohë ka ushtruar ankesë kundër aktgjykit, me datën 30 qershor 2011 dhe e pranuar nga shkrimorja e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë sipas vulës së regjistrimit më 8 qershor 2011. Është pohuar që kundërshtohet dënim i shpallur ndaj të akuzuarit dhe që në vend të tij të shqiptohet një dënim sa më i butë që është i mundur. Sa i përket të pandehurit B [REDACTED] I [REDACTED], Prokurori Publik i Qarkut në Mitrovicë me kohë ka ushtruar ankesë më 6 korrik 2011 dhe ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë lidhur me dënimin e shqiptuar se ishte shumë i butë. Në veçanti është pohuar që aktgjyki i shkallës së parë kryesisht i ka marr paraçysh rrethanat lehtësuese derisa aspektet rënduese të veprës janë lënë anash.

Sa i përket të pandehurit H [REDACTED] K [REDACTED], Prokurori Publik i Qarkut në Mitrovicë parashtroi "opinion" më 18 korrik 2011 duke pohuar që gjykata e shkallës së parë nuk e ka marr plotësisht në konsideratë të gjitha rrethanat rënduese prandaj edhe ankesa e mbrojtjes duhet të refuzohet dhe që dënim i rritet nga Gjykata Supreme.

ZPSbK-ja, me përgjigje të datës 27 dhjetor 2011 dhe e regjistruar me shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës më 29 dhjetor 2011 nuk ka humbur asnjë fjalë lidhur me ankesën e prokurorit të qarkut sa i përket të pandehurit B [REDACTED] I [REDACTED], por ka

përkrahur pozitën ligjore të Prokurorit Publik të Qarkut në Mitrovicë që të refuzohet ankesa e mbrojtjes lidhur me të pandehurin H. [REDACTED] si e pabazuar.

Në pajtim me aktgjykimin me shkrim në lëndën P. nr. 84/08 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 31 mars 2011 (të parashtruar në shkrimore që asaj gjykate në të njëjtën ditë), ankesa e dorëzuar me shkrim e të pandehurit pasi që është dorëzuar përmes avokatit të tij mbrojtës, së bashku me analizat e ligjit të aplikueshëm, Gjykata Supreme e Kosovës, pas këshillimit dhe votimit më 28 shkurt 2012, me anë të kësaj lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e avokatit mbrojtës e parashtruar në emër të të pandehurit H. [REDACTED] refuzohet si e pabazuar.

Ankesa e parashtruar nga Prokurori Publik i Qarkut lidhur me vendimin mbi dënimin kundër B. [REDACTED] është aprovar. Aktgjyimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P. nr. 84/2008, i datës 31 mars 2011, është ndryshuar. Dëimi prej 3 viteve është shqiptuar kundër të pandehurit B. [REDACTED]

Aktgjyimi i Gjykatës së Qarkut vërtetohet në pjesët e mbeturat.

ARSYETIM

Historiku i procedurës

Më 19 qershor 2008, Prokurori Publik i Qarkut në Mitrovicë ushtroi aktakuzë (PP nr.66/08) dhe i akuzoi të pandehurin H. [REDACTED] së bashku me dy të pandehur të tjerrë me Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitia e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike në kundërshtim me nenin 229, paragrafin 2 i lidhur me paragrafin 4, pikën i të KPK-së (pika e akuzës I), sepse më 21 maj 2008 rrëth orës 15:30 në parkingun e marketit EMONA në Vushtrri dhe duke vepruar në grup me të tjerët ai gjoja se kishte në posidim të paautorizuar disa qese të vogla plastike të përgatitura për paketimin e narkotikëve me qëllim të shitjes së tyre, e gjithashtu edhe një çantë që përbante njëzetë (20) farë të marijuanës me qëllim të kultivimit të tyre. Për më tepër, H. [REDACTED] i vetëm, është akuzuar me Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim me nenin 328, paragrafin 1 të KPK-së, sepse në datën, kohën dhe vendin përkatës ai gjoja se ka shfrytëzuar armën (7.62 mm, pistoletën Colt, me numrin serik 423400, të prodhuar në Gjermani, që përbante 5 plumba) ashtu që ai ka shtënë disa herë në drejtim të policit që ka intervenuar, derisa ky i fundit ka arritur që t'ia marr armën nga dora e tij.

Përmes aktakuzës së njëjtë, i pandehuri B- I- eshtë akuzuar me Prodhimi dhe Përpunimi i Paautorizuar i Narkotikëve të Rezikshëm dhe i Substancave Psikotropike në pajtim me nenin 230, paragrafin 1 të KPK-së, sepse pretendohet që në ngjarjen e datës, kohës dhe vendit përkatës i pandehuri në oborrin e shtëpisë së tij dhe pa autorizim ka kultivuar me qëllim të shitjes substancën (domethënë 12 gjethë kanabis) në vazон e luleve, e cila eshtë shpallur si e rrezikshme (substanca e jo vazoja).

Gjyqtarët e EULEX-it e morën lëndën përsipër më 2 gusht 2009.

Më 22 nëntor 2010, aktakuza është konfirmuar nga gjyqtari për konfirmim, i cili e hodhi poshtë aktakuzën kundër një prej bashkë-të-pandehurve dhe e ka ashpërsuar atë lidhur me bashkë të pandehurin tjetër për shkak të mungesës së tij, por e ka konfirmuar lidhur me të pandehurit H. [REDAKTUE] dhe B. [REDAKTUE].

Shqyrtimi gjyqësor kundër H. [REDAKTUE] I. [REDAKTUE] dhe B. [REDAKTUE] II. [REDAKTUE] filloj më 30 dhe 31 mars 2011 para kolegjit të Gjyqtarëve të EULEX-it.

Në seancën e 31 marsit 2011, Prokurori Publik i Qarkut e ndryshoi akuzën kundër H. [REDAKTUE] lidhur me Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim me nenin 328, *paragrin* 2 të KPK-së (pika e akuzës II.2), ashtu që – kur gjykata e shkallës së parë arriti të vendos përfajësinë dhe dënimin e mundshëm të dy të pandehurve, akuzat kundër tyre janë ndryshuar si në vijim:

H [REDACTED] ishte akuzuar me Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike në kundërshtim me nenin 229, paragrafin 2 i lidhur me paragrin 4, pikën i të KPK-së (pika e akuzës I), Prodhimi dhe Përpunimi i Paautorizuar i Narkotikëve të Rrezikshëm dhe i Substancave Psikotropike në pajtim me nenin 230, paragrin 1 të KPK-së (pika e akuzës II.1) dhe me Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim me nenin 328, paragrat 1 të KPK-së (pika e akuzës II.2).

B. I. ishte akuzuar me Prodhimi dhe Përpunimi i Paautorizuar i Narkotikëve të Krezikshëm dhe i Substancave Psikotropike në pajtim me nenin 230, paragrafin 1 të KPK-së, siç është paraqitur në originalin e aktakuzës.

H [REDACTED] I [REDACTED] eshtë deklaruar fajtor për pikën I të aktakuzës (Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitia e Paautorizuar e Narkotikëve të Rezikshëm dhe e Substancave Psikotropike në kundërshtim me nenin 229, paragrafin 2 i lidhur me paragrafin 4, pikën i të KPK-së) dhe të pikës II.2 të aktakuzës (Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim me nenin 328 paragrafit 2 të KPK-së). Deklarata e fajësisë eshtë pranuar nga gjykata.

Prokurori Publik i Qarkut têrroqi pikën II.1 tê aktakuzës (Prodhimi dhe Përpunimi i Paautorizuar i Narkotikëve të Rrezikshëm dhe i Substancave Psikotropike në pajtim me numrin 230, paragrafin 1 tê KPK-së) kundër H. [REDAKTUE]
[REDAKTUE]

Aktgjykim i atakuar është paraqitur gojarisht më 31 mars 2011 dhe i është dërguar palëve në mes të 27 dhe 28 qershor 2011.

Përderisa i pandehuri B. [REDACTED] II. [REDACTED] nuk e kundërshtuar aktgjykimin, avokati mbrojtës i të pandehurit H. [REDACTED] II. [REDACTED] brenda afatit ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit me datën 30 qershor 2011 dhe është pranuar në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë sipas vulës regjistruese më 8 qershor 2011, duke theksuar që dënimini është shumë i lartë.

Sa i përket të pandehurit B. [REDACTED] I. [REDACTED] Prokurori Publik i Qarkut në Mitrovicë me kohë ka ushtruar ankesë më 6 korrik 2011 dhe ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë lidhur me dënimin e shqiptuar se është tepër i butë.

Sa i përket të pandehurit H. [REDACTED] I. [REDACTED], Prokurori Publik i Qarkut në Mitrovicë e ka shkruar "opinionin" që nuk përmban ndonjë datë por është ushtruar më 18 korrik 2011, duke kritikuar se do të ishte shumë i ulët, por e ka lënë vlerësimin në zgjedhjen e Gjykatës Supreme.

ZPSHk-ja, me përgjigje të datës 27 dhjetor 2011 dhe që është e regjistruar në shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës më datën 29 dhjetor 2011, propozoi të refuzohet ankesa e mbrojtjes në emër të të pandehurit H. I. si e pabazuar-kështu që teknikisht duke e cilësuar dokumentin e Prokurorit Publik në Mitrovicë si ankesë- të aprovoj ankesën e Prokurorit Publik si të bazuar dhe të ndryshoj akt gjykimin P. nr. 84/08 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 31 mars 2011 lidhur me vendimin për sanksionet penale. Pjesa e të pandehurit B. I. nuk është adresuar nga ZPSHk-ja.

GJETJET E GJYKATËS

Vendimi mbi dënimin

Aspekti i vetëm i aktgjykimit të shkallës së parë, pasi që është kundërshtuar nga të dy, avokati mbrojtës i të pandehurit H. [REDAKTUE] the të Prokurorit Publik të Qarkut në Mitrovicë në lidhje me të dy të pandehurit, H. [REDAKTUE] dhe B. [REDAKTUE] është vendimi mbi dënimin.

Në soty rastet, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton që çfarëdo shkelje e Ligjit që është bërë nga gjykata e shkallës së parë është kryer në dobi të tij dy të pandehurve.

Sa i përket të pandehurit Hoxha

Mbrojtja, sipas ankesës së tij, është e mendimit që gjykata e shkallës së parë nuk e ka marr parasysh të gjitha rrëthanat lehtësuese në dobi të të pandehurit H. [REDAKTUE] pasi që ekziston në veçanti fakti që ai kurrë më parë nuk e ka shkelur Ligjin, që ai është penduar shumë për kryerjen e veprës përkatëse penale prandaj edhe i ka premtuar gjykatës që ai kurrë nuk do ta përsëris këtë dhe përfundimisht që ai është i vetmi që i siguron ekzistencën familjes së tij.

Prokurori Publik i Qarkut, sipas "opinionit" të tij, ka pohuar që gjykata e shkallës së parë i ka marr parasysh vetëm rrethanat lehtësuese e jo ato rënduese, duke folur në dëm të të pandehurit. Në veçanti, vepra penale Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike në kundërshtim me nenin 229, paragrafin 2 i lidhur me paragrafin 4, pikën i të KPK-së do të ishte e radhitur në nenin 229, paragrafin 4 të KPK-së, e që është arsyesa që do të mund të rëndohej. Për më tepër, do të ishte e paqartë nga aktgjykimi se pse gjykata e ka marr pikëpamjen që përqindja e vogël e THC-së në drogat e konfiskuara në njëfarë mënyre e redukton fuqinë e saj. Përfundimisht, gjykata nuk e ka përfillur faktin vendimtar që drogat dështojnë të arrijnë tek konsumatorët vetëm për shkak të intervenimit tepër aktiv të policisë.

Gjykata Supreme e Kosovës në fillim konstatoi që vetëm dokumenti që është dorëzuar nga avokati mbrojtës teknikisht mund të cilësohet si ankesë, i ushtruar me kohë kundër aktgjykimit të atakuuar të shkallës së parë dhe duke propozuar dënim tjetër apo më të butë kundër të pandehurit H. [REDAKTUE] Në ndryshim të kësaj, dokumenti i dorëzuar nga Prokurori Publik i Qarkut, i cili bille nuk quhet "ankesë" por "opinion" nuk përmban ndonjë propozim të qartë por e lënë në zgjedhje të Gjykatës Supreme të ndryshoj dënimin e shqiptuar për të pandehurit. Vetëm në interes të vlerësimit të përgjithshëm ligor duhet të theksohet që edhe nëse dokumenti i Prokurorit Publik do të merret parasysh si "ankesë", në mënyrë të qartë do të ishte e paafatshme. Përderisa aktgjykimi i atakuuar i është dorëzuar palëve më 30 qershor 2011, dokumenti i Prokurorit Publik të Qarkut është ushtruar me Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë më 18 korrik 2011, i cili nuk është brenda afatit të 15 ditëve pas dorëzimit siç parashihet me nenin 389, paragrafin 1 të KPPK-së. Prandaj, në rastin në fjalë parimi i kufizimit të *reformatio in pejus* aplikohet në dobi të të pandehurit dhe të rezultatit që së paku asnjë dënim i lartë nuk mund t'i shqiptohet atij se sa ai që është paraparë nga aktgjykimi i ankimuar.

Megjithatë, ankesa e mbrojtjes- edhe pse e lejuar nga ligji- është në tërësi e pabazuar dhe pa merita.

Vendimi mbi dënimin është i drejtë dhe i balancuar mirë në pajtim me ligjin.

Sa i përket shqetësimeve të ngritura nga mbrojtja, Gjykata Supreme konstaton që gjykata e shkallës së parë i ka marr parasysh të gjitha aspektet lehtësuese në dobi të të pandehurit H. [REDAKTUE] Gjykata e ka marr parasysh faktin që i pandehuri nuk është dënuar më parë, e cila natyrisht është shprehja e "sjelljes së tij të nëparshme [...brenda së cilës ...] ai kurrë nuk e ka shkelur ligjin", siç është theksuar nga mbrojtja. Gjykata gjithashtu ka marr parasysh deklaratën e fajësisë të të pandehurit dhe në këtë kontekst- edhe pse nuk është përmendur në mënyrë eksplikite në aktgjykim- natyrisht ka marr shënim të pendimit të të pandehurit. Fakti që i pandehuri H. [REDAKTUE] është siguruesi i ekzistencës së familjes së tij i referohet "rrethanave personale të autorit të krimit" pasi që duhet të merren parasysh nga gjykata në pajtim me nenin 64 të KPK-së. Megjithatë, kjo vetëm nuk mund të merret parasysh si rrethana lehtësuese, pasi që kushtet e tij jetësore tashmë kanë qenë të mirënjoyura për autorin e krimtit në kohën kur ai i ka kryer veprat penale në fjalë. Këto rrethana në veçanti nuk mund të shpijnë në rezultat që vetëm për shkak të përkrahjes së nevojave të familjes; autori i krimtit i shmanget dënimit të tij të merituar siç përcaktohet me ligji. Rrethanat e jetës së H. [REDAKTUE] në mënyrë të rreftueshme janë marr parasysh nga fakti që dënimti që i është shqiptuar është pothuajse në nivelin më të ulët të mundshëm në pajtim me ligjin.

Përkundër kësaj, Prokurori Publik bazuar në pranimin e gabueshmë të aktgjykimit të shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka theksuar që i pandehuri B█████ I█████ ka qenë i dënuar "në tri vite e gjysmë burgim për veprën penale sipas nenit 229 paragrafit 4 {1} të KPK-së, dhe të një viti burgim për posedim të armës sipas nenit 328 {2} të KPK-së", ndërsa në fakt ai është dënuar "në 3/tri/ vite burgim për veprën penale Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitia e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike [dhe] të 1/një/ viti burgim për veprën penale Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve" dhe "dënim i unik [prej] 3/tri/ vite dhe 6/ gjashtë muaj burgim, në pajtim me nenin 71 paragrafin 1 dhe paragrafin 2 pikën ii të KPK-së", shqetësimet materiale të prokurorisë nuk mund të merren në konsideratë të mëtutjeshme sa i përket parimit *reformatio in pejus*.

Sa i përket të pandehurit B█████ I█████

Prokurori Publik i Qarkut në Mitrovicë pohoi që trupi gjykues dështoi të marr parasysh rrëthanat rënduese të veprës penale e kryer nga i pandehuri B█████ I█████ dhe ti peshoj ato në mënyrë të duhur. Në veçanti, gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar faktin që B█████ I█████ ka kryer veprën penale që duhet të përfshihet në nenin 229 paragrafin 4 të KPK-së, prandaj edhe paraqet formë të rënduar të kryerjes së atij krimi si të atillë, kjo dispozitë paraqet kornizën e dënimit me gjobë dhe së paku tri vite burgim. Për më tepër, gjykata në mënyrë të gabueshme ka marr parasysh aspekte të caktuar të historisë personale të të pandehurit dhe të veprës penale në fjalë si rrëthana lehtësuese. Kjo në veçanti do ti referohet pretendimit të gjykatës që i pandehuri kurrë nuk është dënuar më parë, përderisa në fakt sipas dokumentit të titulluar *Memorandumi Zyrtarë – Dosja Penale, e cila më vonë ka qenë në dispozicion të gjykatës dhe paleve*; ai ka qenë më parë i dënuar për veprën PRQP (Prishje e rendit dhe qetësisë publike) në lëndën të regjistruar me numrin 2007-BD-1050. Gjithashtu, do të ishte e paqartë se si përqendrimi i pretenduar i ultë i Tetrahydrocannabinol-it (THC-së) në drogat e konfiskuara kanë shpirë gjykatën në opinionin që kjo duhet të merret parasysh si rrëthana lehtësuese në dobi të të pandehurit. Nga fakti që analizat e mjekësisë ligjore kanë dështuar në përcaktimin e përqindjes së THC-së në droga, kjo nuk mundet detyrimiht të shpijë tek pretendimi që kjo përqindje është e ultë. Për më tepër, fakti që drogat kurrë nuk iu janë shpërndarë konsumatorëve të tyre përfundimtarë bazoitet ekskluzivisht në intervenimin e menjëherëshëm dhe tepër aktiv të policisë, e cila është arsyaja se pse sipas opinionit të Prokurorit të Qarkut kjo nuk mund të merret parasysh në dobi të të pandehurit. Gjithashtu nuk do të ishte e arsyeshme të merret parasysh që dhënia pas droge e të pandehurit flet në dobi të tij si rrëthana lehtësuese. Nuk ekziston arsyje për të supozuar që B█████ I█████ do të mund të ndihmonte shitjen e drogës në vlerë prej 1,800 eurove pa pritur disa dobi, në mënyrë të të hollave të gatshme apo furnizimit të drogës.

Gjykata Supreme konstaton që shumica e arsyeve të theksuara nga Prokurori Publik nuk shpjinë detyrimiht në ngritjen e dënimit për të pandehurin B█████ I█████ pasi që karakteri i tyre rëndues nuk mund të përcaktohet në mënyrë të qartë. Në veçanti, gjykata e shkallës së parë nuk ka gabuar duke e marr parasysh faktin që i pandehuri nuk kishte dënimë të mëparshme. Në kontekstin e dhënë, vetëm dënimet nga veprat tjera penale mund të merren parasysh si rrëthana rënduese në dëm të pandehurit derisa në lëndën në fjalë i pandehuri B█████ I█████ është dënuar për Prishje të Rendit dhe Qetësisë Publike, e cila është vetëm kundërvajtje por jo krim.

Gjithashtu, fakti që analizat e mjekësisë ligjore nuk kanë arritur të përcaktojnë përqendrimin e THC-së në drogat e konfiskuara, nuk mund të interpretohet në dëm të të pandehurit. Në kontekstin e dhënë mund të lihet e hapur nëse gjykata e shkallës së parë do të ishte e obliguar të kërkoj apo jo analiza shtesë të mjekësisë ligjore lidhur me përqendrimin e THC-së. Së paku, fakti që gjykata e shkallës së parë ka pretenduar përqendrim të ultë të THC-së në drogat është në pajtim me parimin in *dubio pro reo*.

Fakti që drogat nuk e kanë arritur tregun vetëm për shkak të intervenimit të menjëherëshëm të policisë, natyrisht, nuk mund të përdoret si argument në dobi të të pandehurit. Megjithatë, së paku nuk mund të merret parasysh në dëm të të pandehurit që në këtë mënyrë rezultatet dhe efektet negative të veprave të tij në mënyrë domethënëse janë zvogëluar.

Sa i përket rrethanave të jetës personale të të pandehurit, në veçanti lidhur me dhëni së pretenduar të tij pas drogës, pajtohet me Prokurorin Publik që i pandehuri B-
I- me gjasë nuk do të lehtësonë shitjen e drogës në vlerë prej 1,800 eurove pa pritur disa përfitime, në të holla të gatshme apo të shpërndarjes së drogës. Prandaj, dhënia e tij pas drogës nuk mundet detyrimisht të konsiderohet vetëm si rrethanë lehtësuese, siç është bërë nga gjykata e shkallës së parë.

Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me gjendjen e Prokurorit Publik të Qarkut në Mitrovicë siç është e paraqitur në ankesë, që i pandehuri B [...] I [...] ka vepruar si anëtar i grupit dhe për këtë arsyе veprimet e tij duhet të përfshihen sipas nenit 229 paragrafit 4 të KPK-së, kjo dispozitë paraqet minimumin e dënimit me gjobë dhe të dënimit me së paku tri vite burgim. Asnjë rrethanë e veçantë lehtësuese nuk është radhitur nga gjykata e shkallës së parë me qëllim të arsyetimit të uljes së dënimit të shqiptuar nën kufijtë minimal, siç përcaktohet me ligj.

Për më tepër nevojitet të konsiderohet si rrethanë rënduese që sasia e drogës së shpërndarë dhe të konfiskuar është më tepër se 2 kilogram, e që aspak nuk sasi e vogël.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, nevojitet të merret parasysh që kontributet e lidhura me drogën të B... I... si anëtar i grupit janë mjaft të peshës së ngashme me ato të të pandehurit H... I... Për këtë arsy, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton që lidhja në mes të dënimive të shqiptuara ndaj H... I... si një nga bashkë të pandehurit tjerë të shpërndarjes së drogës duhet të vendoset në lidhje me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit B... I...

Prandaj, Gjykata Supreme konstaton që minimumi i dënimit prej tri (3) vite burgim në pajtim me nenin 229, paragrafin 4 të KPK-së për kontributet e B-
mban ekuilibrin me dënimin e njëjtë (të ndarë) siç i është shqiptuar të pandehurit H-
I-

Në përgjithësi, është vërtetuar që gjykata e shkallës së parë, në pajtim me kornizën e dënimeve të mundshme të dhëna nga ligjet përkatëse, ka shqiptuar dënimë të duhura dhe të ndara për të dy, Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike në kundërshtim me nenin 229, paragrafin 2 i lidhur me paragrafin 4, pikën i të KPK-së dhe Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim me nenin 328 *paragrat* 2 të KPK-së. Të dy dënimet e ndara janë brenda kornizave të përcaktuara nga dispozitat përkatëse ligjore dhe dënnimi unik është krijuar në pajtueshmëri me nenin 71 të KPPK-së.

Duke marr parasysh gjithashtu nivelin e prezikut shoqëror të kryerjes së veprave penale e gjithashtu edhe nivelin e përgjegjësisë së të pandehurit, e fundit është shumë e favorshme dhe përmban dënimin shqiptuar unik.

Për arsyet të lartpërmendura Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv.

Gjykata Supreme e Kosovës
AP.-KŽ. nr. 276/2011
Prishtinë
28 shkurt 2012

Anëtarët e kolegjit:

Marije Ademi
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Valdete Daka
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Avdi Dinaj
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Emine Mustafa
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Kryetar i kolegjit:

Procesmbajtës

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor i EULEX-it